

Nr. 2873/Prot.,

Tiranë, më 26.10.2022

9

VENDIM QARKULLUES

Nr. 60, datë 26.10.2022

“PËR MIRATIMIN E NIVELIT TË PAGAVE NË KUFIRIN MAKSIMAL TË LIDHJES NR. 1, TË VKM-SË NR. 647 DATË 05.10.2022, “PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.748, DATË 11.06.2009, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR TRAJTIMIN ME PAGË...”, PËR PERSONELIN AKADEMIK, TË UNIVERSITETIT TË MJEKËSISË, TIRANË”

Bazuar në ligjin nr.80, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; në Statutin e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë; në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.647 datë 05.10.2022 “Për disa ndryshime në vendimin nr.748, datë 11.06.2009 të Këshillit të Ministrave “Për trajtimin me page”; në Vendimin Qarkullues të Rektoratit Nr.18, datë 25.10.2022; në Vendimin Qarkullues të Senatit Akademik Nr.83, datë 25.10.2022 “Peer miratimin e nivelit të pagave...”, Bordi i Administrimit i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë pasi mori në shqyrtim relacionin e Administratorit të UMT-së nr. 2873/8 prot., datë 26.10.2022 “Mbi miratimin e nivelit të pagave, sipas kufirit maksimal, në zbatim të VKM-së Nr.647 datë 05.10.2022 “Për disa ndryshime në vendimin nr.748, datë 11.06.2009, të Këshillit të Ministrave “Për Trajtimin me Pagë dhe Shtesa” si dhe miratimin e shtesës në buxhetin e vitit 2022, për Fakultetin e Mjekësisë Dentare”,

VENDOSI:

1. Të miratojë nivelin e pagave, sipas kufirit maksimal, të lidhjes nr.1 të VKM-së Nr.647 datë 05.10.2022, për personelin akademik të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, (bashkëlidhur lidhja nr. 1 e VKM-së). Efektet financiare, për çdo nivel page mbi kufirin minimal deri në kufirin maksimal, do të mbulohen nga të ardhurat e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.
2. Të miratojë shtesë, në buxhetin e vitit 2022, në vlerën 400 000 (katërqind mijë) lekë, për paga dhe 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, për sigurime shoqërore dhe shëndetësore, me burim financimi nga të ardhurat e veta, për Fakultetin e Mjekësisë Dentare.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Administratori i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë dhe Drejtorja e Shërbimeve Juridike dhe Burimeve Njerëzore në UMT.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe të publikohet në faqjen zyrtare të internetit të UMT-së.

KRYETAR
ZAMIRA ÇINI

ANËTARË

VERA OSTRENI

ALTINA XHAJERI

MONIKA FIDA

ANIS THODHORJANI

ALBANA GJANOULLI

ENDRIT YZEIRAJ



VENDIM
Nr. 647, datë 5.10.2022

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 748, DATË 11.6.2009, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR TRAJTIMIN ME PAGË DHE SHITESA MBI PAGË TË PUNONJËSVE TË PERSONELIT AKADEMIK TË INSTITUCIONEVE PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve", me propozimin e Kryeministrit dhe ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 748, datë 11.6.2009, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Lidhja nr. 1 zëvendësohet me lidhjen me të një njëjtin numër dhe titull që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Pika 7 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"7. Anëtarët e personelit akademik efektivë, që për nevoja të procesit mësimor, japin orë mësimi mbi normën mësimore vjetore, të miratuar me aktet përkatëse, për çdo orë mësimi, të kryer mbi këtë normë, paguhen, si më poshtë vijon:

a) Kur janë në kategorinë "Profesorë" përfitojnë:

i. për titullin "Profesor", 1 410 (një mijë e katërqind e dhjetë) lekë për çdo orë 60-minutëshe;

ii. për titullin "Profesor i asociuar", 1 295 (një mijë e dyqind e nëntëdhjetë e pesë) lekë për çdo orë 60-minutëshe;

b) Kur janë në kategorinë "Lektorë", përfitojnë 940 (nëntëqind e dyzet) lekë për çdo orë 60-minutëshe;

c) Kur janë në kategorinë "Asistent lektorë", përfitojnë 705 (shtatëqind e pesë) lekë për çdo orë 60-minutëshe."

II. Përballimi i efekteve financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, është, si më poshtë vijon:

1. Për nivelet e pagave sipas kufirit minimal (kolona 2, e lidhjes nr. 1) dhe përcaktimit të pikës 2, të ndarjes I, të këtij vendimi, efektet financiare përballohen për vitin 2022 nga fondet e paketës së rezistencës sociale ndaj pasojave të krizës, ndërsa për vitin 2023 e në vijim nga fondet grant për institucionet publike të arsimit të lartë.

2. Për çdo nivel page të miratuar mbi kufirin minimal e deri në kufirin maksimal (kolona 3, e lidhjes nr. 1), efektet financiare të diferencave midis nivelit të pagës së miratuar dhe atij minimal përballohen nga të ardhurat e veta të institucioneve publike të arsimit të lartë.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 tetor 2022.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

Lidhja nr. 1

STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE PËR PUNONJËSIT E PERSONELIT AKADEMIK NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË

Nr. rendor	Pozicioni/kategoria	Paga	
		Kufiri minimal	Kufiri maksimal
	1	2	3
1	Rektor (titullar i institucionit) me titullin "Profesor"	149 500	160 700
2	Zëvendësrektor me titujt "Profesor" apo "Profesor i Asociuar"	141 500	152 000
3	Zëvendësrektor me gradën shkencore "Doktor (PHD)"	139 600	150 000
4	Dekan me titujt "Profesor" apo "Profesor i Asociuar"	141 500	152 000
5	Zëvendësdekan me titujt "Profesor" apo "Profesor i Asociuar"	129 500	139 200
6	Zëvendësdekan nga kategoria "Lektorë"	114 200	122 700

Faqe|16779



7	Përgjegjës i njësisë bazë me titujt “Profesor” apo “Profesor i Asociuar”	132 500.	142 400
8	Përgjegjës i njësisë bazë nga kategoria “Lektorë”	114 200	122 700
9	Titullar i grupit mësimor/ kërkimor me titujt “Profesor” apo “Profesor i Asociuar”	132 500	142 400
10	Titullar i grupit mësimor/ kërkimor nga kategoria “Lektorë”	114 200	122 700
11	Profesor	129 500	139 200
12	Profesor i Asociuar	112 500	121 000
13	Lektorë	96 700	103 850
14	Asistent Lektorë	78 500	84 400

UDHËZIM
Nr. 28, datë 10.10.2022

PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 31, DATË 26.12.2013, “PËR EMETIMIN NGA QEVERIA E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË OBLIGACIONEVE NË FORMË REGJISTRIMI”, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës dhe neneve 5 dhe 20, të ligjit nr. 9665, datë 18.12.2006, “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ministri i Financave dhe Ekonomisë

UDHËZON:

Në udhëzimin nr. 31, datë 26.12.2013, “Për emetimin nga qeveria e Republikës së Shqipërisë të obligacioneve në formë regjistrimi”, bëhet një ndryshim si më poshtë:

Neni 1

Pika 1 e nenit 9, ndryshohet si vijon :

Shuma minimale e lejuar për pjesëmarrje në ankandet e obligacioneve në lekë është 300,000.00 (treqind mijë) lekë, ndërsa shuma minimale për pjesëmarrje në ankandet e obligacioneve në valute është 3,000.00 (tre mijë) euro/USD.

Neni 2

Ky udhëzim hyn në fuqi pas Botimit në Fletoren Zyrtare.

**MINISTËR I FINANCAVE
DHE EKONOMISË**
Delina Ibrahimaj

**GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE
TË NJERIUT**

SEKSIONI I TRETË

**ÇËSHTJA HABILAJ KUNDËR
SHQIPËRISË**

(Kërkesa nr. 2480/10)

VENDIM
STRASBURG
15 shtator 2022

Ky vendim është i formës së prerë, por mund të bëhet objekt i një rishikimi redaktues

Në çështjen Habilaj kundër Shqipërisë,

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur si një Komision i përbërë nga:

Andreas Zünd, *kryetar,*

Darian Pavli,

Mikhail Lobov, *gjyqtarë*

dhe Viktoriya Maradudina, *sekretar i Seksionit,*

Pasi diskutoi me dyer të mbyllura, më 25 gusht 2022,

Shpall vendimin e mëposhtëm, i cili u miratua në po atë datë:

PROCEDURA

1. Çështja nisi me një kërkesë kundër Shqipërisë paraqitur në Gjykatë në mbështetje të genit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (“Konventa”), më 18 shkurt 2009.

2. Kërkuesi i prezantua nga Z. A. Hajdari, një avokat i cili e ushtron profesionin në Tiranë.

3. Qeveria shqiptare (“Qeveria”) u njoftua për kërkesën.